

Drejtore e Drejtorisë Teknike Ekonomike

Elona Kuçi

Znj. Elona Kuçi është emëruar Drejtore e Drejtorisë Teknike Ekonomike pranë Entit Rregullator të Ujit më 02.06.2025. Znj. Kuçi ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, në degën “Menaxhim”.

Me mbi 13 vite eksperiencë profesionale në administratën publike dhe sektorin privat, ajo ka ndërtuar ekspertizë të gjerë në menaxhimin financiar, analizat ekonomike dhe rregullimin e sektorit të ujit.

Në karrierën e saj, ka kontribuar në hartimin dhe monitorimin e politikave dhe strategjive të menaxhimit të burimeve ujore, ka koordinuar projekte të financuara nga BE dhe donatorë ndërkombëtarë, si dhe ka përfaqësuar institucionet shqiptare në tryeza kombëtare dhe ndërkombëtare.